ARCHIVAL POST

# at-anton-harapi

SECTION

Clergy

PERIOD

1946 - 1946

CATHOLIC PRIEST

MEDIA #1

# Media 1

MEDIA ITEMS #1



DREJTORIJA E MBROJTJES POPULLIT
SEKSIONI MBROJTJES POPULLIT

PREFEKTURES ELBASANIT

--ooOoo--

Nr. 401 Prot

Vdekje Fashizmit
Liri Popullit

Elbasan me 14/II/946.

800 55
22

DREJTORISE MBROJTJES POPULLIT

TIRANE

Ju vema ne dije ni, se me vendimin e Gjykates Ushtarake Tiranes te dates 12/II/946 per denimin me vdekje te Lef Nosit, Pater Anton Arapit, dhe Maliq Bushatit, populli e priti shume mire kete denim, dhe qe me pare e kerkonete qe tre te permendunit te denoheshin me vdekj kurse elementet Rreaksionar nuk e priten mire, por thonin se dynja ashte kjo, dhe se nji koke do te paguhet me mijra koka ma vone.

SHEF I SEKSIONIT M.P.
Kapitan i II-te
( Jani ... )

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #3

# Media 3

MEDIA ITEMS #1



60

PROCES VERBAL BETIMI

Vjeti 1943 me 5 Nanduer ne Tirane ne Selin e Keshillit te Nalte te Regjences,

Perpara Shkelqesave Mehdi Frasheri, Lef Nosi dhe Fuat Dibra edhe ne prani te Shkelqeses Pater Anton Harapi [illegible] dhe me funksione Sekretari Nedim Kokona, Sekretar i Pergjithshem i Kryesis se Keshillit te Ministrave, hyne :

Shkelqesat Rexhep Mitrovica: Kryeminister dhe Zav;Minist i Kultures Popullore
Dr.Rrok Kolaj Minister i Drejtesise
Ing. Xhafer Deva Minister i P.Mbrendeshme
Dr. Sokrat Dodbiba Minister i Financave
Musa Gjylbega Minister i P. Botore
Agr. Ago Agaj Minister i Ekonomise Komb.
Vehbi Frasheri N/Minister i P. Jashteme
Qazim Bllaca N/Minister i Ekonomise Komb.

te emnuem ne dikasteret e sipershenueme me dekretin e sotem te Keshillit te Nalte te Regjences dhe bane betimin ne formen qe vijon: "Betohem perpara Perendise dhe mbi nderin t'em se kam me qene besnik i Atdheut dhe do te respektoj Statutin dhe Ligjet e Shtetit dhe se do te kryej funksjonet e mija me nder e ndergjegje per te miren e Vendit.

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #4

# Media 4

MEDIA ITEMS #1



KSHILLI N.Ç.i KATUNDIT TË LAÇIT

Vdjekje Fashizmit
Liri Popullit

DEKLARATË

Na,Kryesija e Kshillit N.Ç.të Katundit të Laçit, dishmojmë e vertetojmë,nen pergjegjsin t`onë se,me 6 tetuer,1944, në Katundin t`onë ndolli shka vijon:

Mbas nji sulmi të pashoq e kreshnik,qi bâni çeta e Partizanvet këtû në Laç,kundra ushtris barbare gjermane,(në krye së cillës çetë partizane ishte Komisàr Brigate Merkur Çela),gjermanët shtuen çetat e veta,sulmuen katundin e dogjen shtatë shpì,bashkë me shpì famullitare.Në ket rasë gjermant plagosen famullitarin,A. Marjan Prêlaj e me 11 tjerë môrren e dergohen në burgun e mndershem të Shkoders.

Personat e burgosun jânë këto:P.Marjan Prêlaj famullitàr,Ndrè Gjetani Kryetari i Kshillit N.Ç. i Laçit,Pal Marku Sekretàr i K.N.Ç.Nikollë Bardhi,Marka Gjini,Gjergj Pali,Nikollë Pasha,Pjeter Nikolla,Nikollë Shkorreti,Marja Gjini,Pal Hilla e Anton Magjolini.

Njoftojmë,pra,se P.Anton Harapi,ky i vetmi,nderhini e pshtoi shpirtent e jeten e 12 vetve nalt të permendun,qi ishin nder duer të pamshirshme gjermane e në burgun e tyne të rrezikshem, tue i lirue prejë burgut e tue kthye të gjith nder shpija të veta.

Kaq na thotë detyra per me lshue ket deklaratë të njoftueme prejë Nesh.

Kryetari i Kshillit N.Ç.i Kat.t,Laçit

Sekretari:
Pal Mark Zimaj

Ndrè Gjetani

KËSHILLI NAC. ÇL. I KATUNDIT LAÇ

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #5

# Media 5

MEDIA ITEMS #1



116

V.F. L.P.

DEKLARATË.

I nenshkruemi Besim Viladi prej Tirane,mbi gjendjen e të pandehurit të burgosun Patër Anton Harapit me ndergjegje të pastër dhe me frikën e Zotit,deklaroj sa më poshtë;

Në muajin e Frorit 1944 disa dit pas terrorit të tmershëm e të paharrushëm që ngjau në Tiranë kam qenë sherbtor në Institutin e Studimeve,të cilin e kryesonte Patër Anton Harapi; në atë kohë jam arestue prej Major Beqir Malokut i Regjimentit Ksova tue më konsiderue si të dyshimtë pse veprojshe fshehtazi në favor të Lëvizjes Nacjonal-Çlirimtare;mbasi jam arestue kanë ardhë e kanë ba një kontroll të imtë në Institut ku më kanë gjetur të fshehur në tavolinën t'ime një revolver me 35 fyshekë dhe pesë bomba plasëse.Atëherë Patër Anton Harapi si ka lënë me i marrë ato,por i ka thënë se këto janë të gjendarmeris s'onë e kështu mua më mbëloj akuzën e rëndë dhe nderhyni për lirimin t'im nga burgu.pas dy muajsh u-lirova e dha urdhën që të më paguhen edhe rrogat e prapambetura.

Këto i vertetoj edhe me bé në rast se thirrem si dishmitar mprojtës për Patër Anton Harapin.

Tiranë 25 gusht 1945

Deklaruesi

Besim Viladi

prej Tirane sherbtor pranë

Institutit të Studimevet

ADSH

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #6

# Media 6

MEDIA ITEMS #1



114

**DEKLARATË**

I nenshkruemi, Injac Gjergj Ndojaj, profesuer i shqencave në Lyceum të Shtetit, Shkoder, lindun po në këte qytet me 1915, deklaron sa vijon:

në dhetorin e vitit 1943, qeshë kapë e futë në burg, nder arrestimet ma të para qi bani RRegjimenti Kossova qi kishte arrijtë dy dit ma parë në Shkoder ardhun prej Kossovet. I nenshkruemi, nen tmerin e torturat qi ushtrojshin kossovarët mbi t'arrestuemët komunista, ndeji nji javë në burg i akuzuem si komunist i zellëshem, si nji nder elementat ma të rrezikëshem t'agjitacjonit të mbrendëshem dhe si nderlidhës i shokut ilegal, profesor Mark Ndoja. Me këto akuza, sigurisht qi puna e të nenshkruemit do të kishte shkue shumë keq, mos t'ishte kenë Pater Anton Harapi, i cili me nderhymje direkte pranë Xhafer Devës, bani qi të më lirojshin prej burgut.

Gjithashtu gjatë arrestimeve qi bani Hasan Isufi dhe Mato Murati per të grumbullue elementat liri-dashtës dhe luftarë kunder nazi-fashistave, per ti dergue peng nder fushat e perqendrimit të Prishtinës, i nenshkruemi njoftue me kohë per këto arrestime, ka mbetë mëshefë nder Freten, ushqye e mbprojtë, me gjith dijeninë e Pater Antonit.

Mbi sa permban këjo deklaratë, i nenshkruemi qi s ka kurfarë gjinije me Pater Antonin, betohet n'emen të Zotit dhe të nderit të vet.

Prof. Injac Gj. Ndojaj

Injac Gj. Ndojaj

Shkoder me 14-VII-1945.

Vertetohet nenshkrimi i Ejup Gjyrezit,
Notër Publik pranë ksaj Gjykatë.
Shkodrë, me 30.8.945
Kryetar i Gjykatës Prefekturës:
(D. Miçaço)

ADSH

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #7

# Media 7

MEDIA ITEMS #1



V.F.L.P. 110

Une e nenshkruegja, Age Gjon Gruda, me banim ne Tirane deklaroj sa vájon:

Me daten 19 Qershuer 1943 ne Tuz ishin bashkue te gjith burrat e Malcís së Madhe të Shkodrës, simbas thirrjes së Dodë Nikolles, e urdhnit të Kolë Bibë Mirakaj. Qellimi ishte me shkrue milicë e gjendarë burrat e Malcís e me i nisë per ne Shqipnín e Jugut kundra Lëvizjes Nacjonal Çlirimtare.

Tue pasë folun shumica në favor, nderhyna edhe vete në atë çashtje, dhe me fjalë te mija e vuna në beh popullin të hapte sŷtë dhe mos të dergonte milicë e gjendarë, dhe populli u revoltue ku=ndra dergimit te milicvet, pse ishte nji vlla=vrasje.

Mbas kesaj negjarje unë kjeshe kapë e prû në burg të Shko=dres. Major Dodë Nikolla me Mato Muratin me shokë kerkuen djegjen teme me benzinë, per te dhanë shembullin barbar kundra kujdo, qi guxonte t'u sabotonte punen. Familja e eme atëhere shkoi te Pater Anton Harapi, dhe ai ndermjetsoi dhe më shpetoi prej vdekjes, shkur toi ditet e mija ne burg, pregatit lirimin tem, dhe [illegible] nga ky ndërmjetsim u lirue prej burgut edhe vllau i im, i cili ishte kenë kapë bashkë me mue.

Njikohesisht per hirin e se vertetës deklaroj se Pater Anton Harapi âsht ai qi keshilloi malsoret e Hotit, të Grudes e të Tuzit, q[illegible] t'i hapshin sŷt dhe mos t'u gabojshin as vetë as të shtŷm prej kujdo me u keqsue me asnji partí e me kalue kufinin, per t'u ngatrrue me partizanët malazez.

Per sa shkrova jam gati të deklaroj edhe me gojë si para Gjyqit ashtu edhe para kujdo tjeter, mbasi kjo âsht e vertete dhe për mue nji detyrë per shka bani per mue.

Deklaruesja
(Age Gjon Gruda)
Age Gjon Gruda

ADSSH

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

MEDIA #8

# Media 8

MEDIA ITEMS #1


113

VDEKJE FASHIZMIT          LIRI POPULLIT

DEKLARATË

I nenshkruemi Anton Mazreku, ish nëpunës në Ministrin e Arsimit, dhe tash Profesor në Liceun Shtetnuer të Tiranës, mbi pergjegjësin t'eme personale deklaroj:-

Me daten 7/I/1945 bashkë më Nëpunës të tjerë të Ministris s'Arsimit kamë qenë arestue prej Organeve të Sigurimit Publik t'asaj kohe.-

Vertetoj se vetem me ndermjetësimin e P.Anton Harapit jam lirue nga burgu me daten 10/I/1944.-

Mbi sa deklarova sipri jam gadi t'a parashtroj edhe para gjyqit.-

Tiranë më 4/X/1945

DEKLARUESI
(Anton Mazreku)
Anton Mazreku

AIDSSH

## INFORMATION

No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.